



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Korçë, më _____. 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje makina me kosh dhe kamionçina”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kamionçina 34136200-1

Automjete të specializuara 34114000-9

VLERA E FONDIT LIMIT QË PROKUROHET: 8,327,000 (tetë milion e treqind e njëzet e shtatë mijë) lekë PA TVSH

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Nderrmarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe

të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

3. Operatorët ekonomikë duhet të dorezojnë :

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Licencën e kategorise VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e ministries së transportit dhe infrastruktures me nr.1546, datë 29.03.2016.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", si dhe Udhëzimin e ministries së transportit dhe infrastruktures me nr.1546, datë 29.03.2016. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mjetit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për këtë mjet i cili do të ndihmojë NSHP në proceset e punës për kryerjen e detyrave funksionale.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Termat e references, sasite, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjes për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin Nr.343, datë 22.09.2025.

Ato janë si me poshte:

NR	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1	Kamioncina vetshkarkuse	cope	3
2	Makine me kosh	cope	1

SPECIFIKIMET TEKNIKE KAMIONCINA

- Kamioncina duhet të jetë me të gjitha pajisjet standarte normale, dhe e gatshme për punë.
- Karakteristikat e sigurisë të sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit, dhe të gjitha paisjet dhe aparaturat duhet të jenë funksionale dhe konform rregullave dhe standardeve të Bashkimit Europian.
- Gabina duhet të jetë konform rregullave të Bashkimit Europian, me sistem të ngrohjes dhe ftohjes (Kondicioner),dobio gabine.
- Kamioncina duhet të jetë e tipit veteshkarkues me karroceri metalike
- Mjeti duhet te kete me dopio gome ne aksin e pasem.
- Mjeti të jetë jo më i vjetër se viti 2011
- Lenda djegese ,Naftë
- Trasmesioni ,Manual
- Xhamat e dyerve para me hapje-mbyllje elektrike
- Masa e mjetit plot jo me pak se 3500 kg
- Motorri të jetë me naftë me ftohje me lëng me fuqi jo më të vogël se 90 kw
- Vellimi i motorit te jete jo me i vogel 2200 cc
- Pjesët hidraulike të jenë pa rrjedhje
- Mjeti duhet të realizojë operimin kazanit (karrocerise): Te shkarkoje majtas-djathtas dhe mbrapa.
- Mjeti duhet të jetë i mbuluar me një garanci teknike dhe sherbimi , një vit nga dita e marrjes ne dorezim.
- Mjeti duhet te jete me dokumentacion te rregullt I targuar sipas standarteve te DPSHTRR(targa, taksa, siguracion, kolaudim).

SPECIFIKIMET MAKINE ME KOSH

- Kamioncina duhet të jetë me të gjitha pajisjet standarte normale, dhe e gatshme për punë.

- Karakteristikat e sigurisë të sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit, dhe të gjitha paisjet dhe aparataturat duhet të jenë funksionale dhe konform rregullave dhe standardeve të Bashkimit Europian.
- Gabina duhet të jetë konform rregullave të Bashkimit Europian, me sistem të ngrohjes dhe ftohjes dhe me vende ulse jo me pak se dy.
- Mjeti duhet të ketë me dopio gome në aksin e pasëm.
- Numri i dyerve dy
- Mjeti të jetë jo më i vjetër se viti 2010
- Lenda djegese ,Naftë
- Trasmisioni ,Manual
- Xhamat e dyerve para me hapje-mbyllje elektrike
- Masa e mjetit plot jo me pak se 3500 kg
- Motorri të jetë me naftë me ftohje me lëng me fuqi jo më të vogël se 60 kw
- Vellimi i motorit të jete jo me i vogël 2200 c
- Pjesët hidraulike të jenë pa rrjedhje
- Pesha e ngritjes së koshit në lartësi maksimale të jetë jo me pak se 200 kg
- Të jetë me katër këmbë mbështetëse, me piston hidraulik
- Rrotullimi i pistonit të koshit të jete 360 °
- Pulti i komandimit të jetë në mjet dhe në kosh
- Lartësia e krahut ngrites të koshit të jete jo me pak se 19m
- Mjeti duhet të jete me dokumentacion të rregullt I targuar sipas standarteve të DPSHTRR (targa, taksa, siguracion, kolaudim).
- Mjeti duhet të jetë i mbuluar me një garanci teknike dhe shërbimi , një vit nga dita e marrjes në dorezim.

Në cmim përfshihen të gjitha veprimet dhe shpenzimet deri në kalimin e pronësisë së mjeteve në emër të NSHP-së.

GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Afatet e ekzekutimit: **30 (tridhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës .**

Nr.	Emertimi	Shuma	Destinacioni	Periodha e dorëzimit
1	Kamiocina vetshkarkuse	3 copë	NSHP	30 ditë
2	Makine me kosh	1 copë	NSHP	30 ditë

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mjeti duhet të jete i pajisur me dokumentat përkatëse sipas DPSHTRR (targa,taksa,siguracion,tahograf,kolaudim).

Në cmim përfshihen të gjitha veprimet dhe shpenzimet deri në kalimin e pronësisë së mjetit në emër të NSHP-së.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë mjetet në përputhje me standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri në dorëzimin në vendin e përcaktuar që është magazina e Ndermarrjes së Sherbimeve publike, Bashkia Korçe.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kërkuara sipas standartit të kërkuar si më sipër.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT

PËLLUMBESHA NURÇE (KRYETARE)

KLEA QYLAFI (ANËTARE)

LILJANA MYRTOLLARI (ANËTARE)